



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
TIRANE

---

KËRKESE  
Për vleftësim arresti dhe caktim mase sigurimi

GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANE

---

Ne Tirane , me 23.11.2018

Ne Kreshnik Ajazi dhe Ndini TAVANI, Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane , pasi studiuam aktet e procedimit penal nr 9146/2018,

K O N S T A T U A M :

Prokuroria prane gjyktates se shkalles se pare Tirane , ka regjistruar procedimin penal nr 9146/ 2018 per veprat penale te parashikuara nga nenet 236/2 , 262 , 274 dhe 237 te K.Penal.

Nga materialet e para hetimore ka rezultuar se :

Fakti penal :

Me daten 22.11.2018, rreth ores 10:30, ne rrugen Xhroxh Bush dhe pikerishte para parlamentit nje numer I konsiderueshem personash ,po zhvillonin nje proteste kunder vendimit per prishjen e shtepive ne Zonen e Unazes se Re Tirane.Gjate zhvillimit te protestes disa persona kane hedhur kapsolla ,shishe plastike uji si dhe shkopa druri kundrejte punojesve te policise te cilet ishin te planizuar me sherbim ne hyrje te Parlamentit ku disa nga keta punojes jane demtuar .

Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është bërë procesverbali i kqyerjes së vendit të ngjarjes. Vendi i ngjarjes është hyrja kryesore e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në afersi të sheshit Fan Noli Tirane. Gjate kqyerjes së vendit të ngjarjes në sipërfaqen e e shtruar me beton janë gjetur dhe sekuestruar në çilesinë e provës materiale 4 kapsolla me ngjyre të kuqe të pa plasur,6 kapsolla me ngjyre të kuqe dhe të zeze të plasura,12 bidona me mbishkrime të subjekteve që I tregetojne ,1kapak stilografi ngjyre blu,tabela me mbishkrime , dy shkopinje

druri,dy copa perde me mbishkrime . Eshte bere vendimi i ekspertimit daktiloskopik vleresues te shisheve plastike objekte ekspertimi si dhe eshte bere vendimi i ekspertimit kimik te kater kapsollave te pa plasura.

**Ne lidhje me kete ngjarje eshte mare deklarim qe tregon rrethana hetimi punojeses se policies, te demtuares Ina Muka** e cila eshte punojese e repartit Shqiponja Tirane . Ajo ka qene me sherbim ne hyrje te Kuvendit ne rreshtin e dyte dhe gjate protestes ajo ka pare qe protestuesit kane ardhur me pankarta ne duar si dhe me bidona plastike dhe kapsolla,dhe nderkoh qe po zhvillohej kjo situuate ne nje momente ajo ka ndjere nje djegie ne pjesen e qafes nga ana e djathte e saj dhe njekohesishte nje ere tymi dhe menjehere ajo ka vendosur doren e djathte ne pjesen e qafes dhe ne kete momente ka degjuar nje shperthim dhe dhimbje ne pjesen e qafes dhe ne doren e djathte. E demtuara ka deklaruar se kapsolla ka ardhur perballe ne drejtim te Komunitetit Myslyman .Eshte bere edhe kqyerja fizike e shtetases Ina Muka ku konstatohet demtime ne pjesen e qafes nga ana e djathte e saj,demtime ne gishtin tregues dhe gishtin e mesit ted ores se majte,si dhe demtime massive ted ores se djathte me apuntim teresor te gishtit te madh.

**Eshte mare kallezim punojesis te policise se Komisariatit te Policise nr 1 Tirane shtetaset Agim Troci,** i cili ka qene i planizuar me sherbim ne hyrjet te Parlamentit ne anen e rruges se Elbasanit dhe pasi ai ka pare se protestuesit kane perparuar te hyjne ne Parlamente ai ka shkuar ne ndime te kordonit te policise ku ai ka pare qe nje person i gjate 175 cm me floke gjysem bjond me xhup te kuq me blu me bluze blu me tuta sportive ngjyre gri e ka goditur me grushte ne fytyre dhe pasi kane nderhyre sherbimet e tjera per te na ndare ai ka tentuar perseri ta godasi ate me shkelma.Pasi eshte bere e mundur shoqerimi ne Komisariat ky person quhej Fluturim Rexhep Goleci I datelindjes 20.05.1988 lindur ne Diber dhe banues ne Paskuqan.

Punonjes te policies se Shtetit jane pyetur nga oficret e policies gjyqesore. Ata kane deklaruar per dhune fizike te ushtruar ndaj tyre nga persona qe merrin pjese ne proteste, persona te identifikuar deri ne kete faze te hetimeve si dhe persona te tjere per te cilet po hetohet per identifikimin e tyre.

**Eshte perpiluar raport sherbimi nga punonjesit e Komisariatit Nr 1 Tirane** te cilet ishin te vendosur ne sherbim ne lidhje me protesten dhe gjate sherbimit ata kane evidentuar disa persona qe kane bere veprime te dhuneshme si duke gjuajtur punojesis e policise me shashka,flakadane,si dhe sende te fort ate cilet jane shoqeruar ne Komisariat me emrat Alban Qemal Ahmetcenaj,Paolo Ajet Ahmetcenaj,Fluturim Rexhep Golemi,si dhe jane evidentuar shtetaset Dorjan Protohuari dhe , Luan Metalia . Deri ne kete faze te hetimit rezulton se shtetaset e mesiper kane goditur me kapsolla dhe sende te forta ne drejtim te punojesve te policise.

**Eshte perpiluar raport sherbimi nga punonjesit e policise te seksionit te forces se posaçme Shqiponja** te cilet pasi kane mare njoftim ne lidhje me dy persona qe dyshohen se kane hedhur kapsolla pasi ishin pjesmares ne proteste qe do zhvillohej ne hyrje te Parlamentit te cilet ishin Alban Ahmetcenaj i datelindjes 30.09.1980,te cilit gjate kontrollit ju gjeten nje kapsolle piroteknike me ngjyre te kuqe me mbishkrimin Enigma Fire Works,eshte shoqeruar shtetasi

Paolo Ahmetacenaj i datelindjes 03.07.2001 ku gjate kontrrollit fizik te tij jane gjetur 40 (dyzet)kapsolla piroteknike me ngjyre te kuqe me mbishkrimin Enigma Fire Works,ku 20(njezet)cope jane gjetur ne xhepat e tij te xhupit dhe 20(njezet)cop jane ne nje kuti te pa hapur te cilen e mbante ne nje çante shpine.Ne lidhje me kete raporte sherbimi eshte bere edhe kapja ne flagrance te tyre.

**Eshte perpiluar nje raport-sherbimi nga punojes te policise se Komisarariatit Nr 4 Tirane** te cilet jane planizuar me sherbim ne afersi te parlamentit ku gjate zhvillimit te protestes ata kane pare qe protestuesit kane filluar te kryenin veprime te dhuneshme ndaj punojesve te policise duke qelluar ne drejtim te punojesve me uniforme me sende te forta dhe fishekzjarre.Nga ana e tyre jane evidentuar dy persona te cilet ishin ne rradhet e para te protestuesve te cilet ushtronin dhune ndaj punojesve te policise te cilet jane shtetasit Amarildo Bexhet Sinanaj dhe Shpati Hyso Bilbilaj. Ne lidhje me keta shtetas eshte bere edhe video me pamje filmike nepermjet celulareve. Nga ana e punojesve eshte bere edhe keqyerja e pamjeve filmike,ku ne kete pamje shikohet nje person I veshur me nje bluze sportive me ngjyre te zez dhe me nje çante krahu me pak mjeker eshte me floke te zeza me vetulla normale fytyre rrumbullaket I cili ndodhet ne mesin e turmes dhe ndez nje kapsoll dhe e hedh ne drejtim te punojseve te policise.Gjithashtu shikohet nje femer e veshur me xhup te holle me ngjyre gri me floke te verdha te kapura siper me njekase e cila shikohet ne fillim te turmes se protestuesve dhe fillon te dhunoj punpojsit e policise.Gjithashtu shikohet nje person ne mesin e protestuesve i cili eshte i veshur me nje xhup me ngjyre te zeze sportive dhe mban ne duar nje bankart.Ky shtetas eshte me floke me ngjyre geshtenje me mjeker i pa rruar i cili fillon te gjuaj ne drejtim te punojesve te policise me bankarte qe mbante ne dore si dhe me nje derrase qe e mer ne toke.Po ne kete pamje shikohet edhe nje person tjeter i cili ndez nje kapsoll dhe e hedh ne drejtim te punojesve te policise.

**Eshte perpiluar nje raport-sherbimi nga punojes te policise se Komisarariatit Nr 3 Tirane** te cilet jane planizuar me sherbim ne afersi te kuvendit ku gjate zhvillimit te protestes ata kane pare qe protestuesit kane filluar te kryenin veprime te dhuneshme ndaj punojesve te policise duke qelluar ne drejtim te punojesve me uniforme me sende te forta dhe fishekzjarre.Nga ana e tyre jane evidentuar shtetasit Rruzhdi Dukagjin Daci,Fejzi Mino,Marsel Velillari Gezim Sadikaj.Ne lidhje me keta shtetas eshte bere edhe video me pamje filmike nepermjet celulareve ku me pas eshte bere edhe kqyerja e pamjeve filmike te cilat jane hedhurne DVD ku ka rezultuar se e oren 01:32 te dates 22.11.2018 kane identifikuar shtetasit Gëzim Sadikaj I cili eshte I vendosur ne reshtin e pare perballe parlamentit duke ushtruar dhune dhe konfroktohet me punojisit e Policise dhe me Drejtorin e Policise Tirane Z.Kastriot Skënderaj si dhe vihet re se persona te pidentifikuar kane hedhur kapsolla ,tymuese si dhe sende te forta duke rezikuar rende shendetin e punojseve te policise.

**Eshte perpiluar disa raporte-sherbimi nga punojes te policise se Komisarariatit Nr 1 Tirane** te cilet jane planizuar me sherbim ne afersi te

parlamentit ku gjate zhvillimit te protestes ata kane identifikuar shtetasit Sali Lusha,disa deputet te opozites si Salianji,Boçi,Balliu,Gjyshaj dhe Vasili.

**Eshte perpiluar nje raport sherbimi nga Seksioni I Operacioneve Speciale** te cilet kane bere foto dhe filmime ne lidhje me protestueset ku ne dr te tjera kane konstatuar nje shtetas te seksit mashkull i moshes 35 vjeç trup te shendosh me floke te rena i gjate rreth 180 cm i veshur me xhup te zi i cili kundershonte punojst e policise si dhe ka hedhur sende te ndryshme si kapsolla tymuese etj i cili pasi eshte shoqeruar eshte identifikuar si shtetasi Dorjan Protoduari.Ne oren 11:12 kane konstatuar nje shtetas rrerth oshes 20 vjeç i gjat rreth 180 cmi veshur me xhup me ngjyre te zez me kapuç me bluze gri e erret i cili bente veprime dhune ndaj punojesve te policise.Ne oren 11:25 eshte konstatuar nje person i moshes 50 vjeç i veshur me xhup te zi me kapuç i cili bente veprime te dhuneshme ndaj punojesve te policise i cili pasi eshte shoqeruar eshte identifikuar si shtetasi Rruzhdhi Daci.Rreth ores 11:30 eshte konstatuar dy shtetas Alban Ahmetcenaj dhe Paolo Ahmetcenaj te cilet qellonin kordonin e policise dhe hidhnin kapsolla dhe tymuese ku njeri nga keta persona eshte i moshes 20 vjeç i veshur me xhup te zi dhe me nje çante te zeze me figura ngjyre gri ndersa tjetri i moshes 30 vjeç me mjeker me xhup te zi.

**Eshte perpiluar nje raport sherbimi nga nd/specialist** prane seksionit te krimeve ndaj Prones ku thuhet se shtetasi Ali Tahir Nalic i datelindjes 03.09.1983,lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane eshte pare duke kryer veprime te dhuneshme duke tentuar te kaloj me force kordonin e punojesve te policise.

**Nga ana jone eshte bere keqyerja e pamjeve filmike** te nxjera nga interneti ne lidhje me protesten e dates 22.11.2018 ku shikohen pamjet filmike te protestuesve qe godasin dhe hedhin kapsolla ne drejtim te punojesve te policise ku me pas jane demtuar punojesaja e policise Ina Muka dhe Dhimitraq Ziu.

**Eshte bere keqyerja fizike dhe marja e faktoreve plotesues te qitjes per shtetasit:**Amarildo Sinanaj,Shpati Bilbilaj,Marsel Velillari,Lulzim Dozhllani,Erjona Dozhllani,Ali Nalic,Paolo Ahmetcenaj,Alban Ahmetcenaj,Dorjan Protoduari.Rruzhdhi Daci,Flurim Goleci,Ermir Goleci,Mariglen Braçaj,Adem Cara Bujar Gjata.

**Eshte bere vendimi i ekspertimit mjeko-ligjor** per punojst e policise,I Nuka,K.Muçolli,A.Asllanaj,K.Bala,Q.Brahimi,F.Kopani,H.Polici,G.Sula,R.Murataj, E.Asllanaj,L.Osmani,M.Luli eshte bere vendimi i ekspertimit kimik ne lidhje kapsollat te gjetur ne vendin e ngjarjes si dhe kapsollat sekuestruar shtetetasve Alban dhe Paolo Ahmetcenaj.Eshte bere vendimi i ekspertimit kimik per faktore plotesues te qitjes.

Per sa me siper pasi jane administuar prova materjale nga raportet e sherbimit dhe kapjes ne fragrance te punojesve te policise si dhe jane nxjere edhe fotografime te personave te arrestuar ne momentin qe ata kane gjuajur me mjete te forta nga pamjet filmike te administruara nga ana jone.

**Ne lidhje me kete ngjarje eshte bere arrestimi ne fragrance i shtetasve:**Alban Ahmetcenaj,Paolo Ahmetcenaj,Lulzim Dozhdani,Fluturim Goleci,Ruzhdi

Daci, Marsel Velillari, Dorjan Protoduari, Amarildo Sinanaj, Shpati Bilbilaj, Ali Nalic dhe Erald Muçaj për veprat penale, "Goditje për shkak të detyres", "Kundershtim i punojsit të rendit publik", "Organizim dhe pjesëmarrje në grumbullim dhe manifestim në mënyrë të paligjshme, Prishje e rendit dhe qetesise publike të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 262, 236/2, 237 dhe 274 të Kodit Penal

Arrestimi i këtyre shtetasve duhet të vleftehet i ligjshëm për shkak se:

1. Ekzistojnë kriteret për arrestimin në flagrancë parashikuar nga neni 251/2 i Kodit të Procedurës Penale.
2. Arrestimi i tij është bërë në gjendje flagrance në bazë të nenit 251/2 të Kodit të Procedurës Penale, menjëherë pas kryerjes së veprës penale.
3. Kërkesa për vleftësimin e arrestit është paraqitur në gjykatë, brenda afatit ligjor prej 48 orësh nga çasti i arrestimit,

Gjithashtu, ekzistojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta, të parashikuara nga nenet 228, 229 e 230/1 të Kodit të Procedurës Penale për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues ndaj të arrestuarit, për shkak të mekanizmit të kryerjes së veprës penale, rrezikshmerisë së autoreve dhe të veprave penale, pasojave të ardhura.

Nga sa më sipër rezulton se ekzistojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga neni 228, 229, , 238 dhe 234, të K.Pr.Penale, për caktimin e masës së sigurimit detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, dhe arrest në burg dhe me konkretisht:

1. Egziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se shtetasit e arrestuar, kanë kryer veprën penale të parashikuar nga nenet 236/2, 237, 262 dhe 274 të K.Penal. Ky dyshim mbështetet në:
  - Procesverbali i arrestimit në flagrancë
  - Procesverbali i kqyrjes së vendit të ngjarjes
  - Raportet e shërbimit të punonjësve të policisë së shtetit
  - Procesverbalet e kallezimit të veprës penale
  - Procesverbalet e deklaramentit të personave që kanë dijeni për veprën penale
  - Procesverbalet e sekuestrimit të provës materiale
  - Procesverbalet e kqyrjes së pamjeve filmike
  - Vendimet për kryerjen e akteve të ekspertimit mjekoligjor, kimik dhe për faktoret plotësues të qitjes.
  - Nuk ekzistojnë shkaqe padenueshmërie apo të shuarjes së veprës penale, shtetasit e arrestuar janë madhor dhe i përgjegjshëm përpara ligjit

Shtetasi **Erald Muçaj**, i datëlindjes 21.08.1996, lindur dhe banues në Tiranë. Sipas raportit të shërbimit të punonjësit të policisë Elton Shuli, me detyrë Nd/Specialist i Policimit në Komunitet, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas ishte në rradhënë e parë të protestuesve, duke shtyrë dhe ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë. Pasi është verifikuar në rrugë operative se ky shtetas



punonte si kamarier pranë Hotel Brodëay Tiranë, është bërë shoqërimi i tij për në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Shtetasi **Dorjan Protoduari**. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, N/Komisar Kreshnik Aliaj, N/Komisar Ilirjana Zylfo, Inspektor A.Xhepa, G.Bajrami, D.Peci, E.Isufi, I.Lurtaj, E.Reci, A.Hoxha, E.Mekshi, S.Omeri, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas kundërshtonte punonjësit e policisë, duke hedhur sende të ndryshme si kapsolla, tymuese etj. dhe për këtë është shoqëruar nga shërbimi Shqiponja, nga ambjentet e Spitalit të Traumës.

Shtetasi **Amarildo Bexhet Sinanaj**. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, Jorgo Qirici, Anton Gjeci, Shpëtim Karaj, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas ishte në rradhën e parë të protestuesve, duke ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë dhe për këtë është bërë shoqërimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Shtetasi **Shpati Hyso Bilbilaj**. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, Jorgo Qirici, Anton Gjeci, Shpëtim Karaj, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas ishte në rradhën e parë të protestuesve, duke ushtruar dhunë ndaj punonjësve të policisë dhe për këtë është bërë shoqërimi në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Shtetasi **Ali Tahir Nalic**, i datëlindjes 03.09.1983, lindur në Kukës, banues në Tiranë tek ish Uzina e Autotraktorëve. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, Nd/specialist Grisild Kariq dhe Shkëlqim Tola, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas ka kryer veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë, si dhe ka bërë thirrje për tu futur në Parlament. Pas përfundimit të protestës, është shoqëruar në ambjentet e Drejtorisë së Policisë Tiranë.

Shtetasi **Ruzhdi Daci**, i datëlindjes 01.06.1965. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, N/Komisar Kreshnik Aliaj, N/Komisar Ilirjana Zylfo, Inspektor A.Xhepa, G.Bajrami, D.Peci, E.Isufi, I.Lurtaj, E.Reci, A.Hoxha, E.Mekshi, S.Omeri, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas kryente veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë dhe për këtë është shoqëruar në ambjentet e Komisarariatit të Policisë nr. 3.

Shtetasi **Alban Qemal Ahmetcenaj**, i datëlindjes 30.09.1982, banues në zonën e Unazës së Re. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, N/Komisar Kreshnik Aliaj, N/Komisar Ilirjana Zylfo, Inspektor A.Xhepa, G.Bajrami, D.Peci, E.Isufi, I.Lurtaj, E.Reci, A.Hoxha, E.Mekshi, S.Omeri, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas qëllonte kordonin e policisë, duke hedhur kapsolla e tymuese dhe për këtë është shoqëruar nga shërbimi Shqiponja.

Shtetasi **Paolo Arjan Ahmetcenaj**, i datëlindjes 03.07.2001, banues në zonën e Unazës së Re. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë, N/Komisar Kreshnik Aliaj, N/Komisar Ilirjana Zylfo, Inspektor A.Xhepa, G.Bajrami, D.Peci, E.Isufi, I.Lurtaj, E.Reci, A.Hoxha, E.Mekshi, S.Omeri, datë 22.11.2018, rezulton se ky shtetas qëllonte kordonin e policisë, duke hedhur kapsolla e tymuese dhe për këtë është shoqëruar nga shërbimi Shqiponja.

Shtetasi **Lulezim Dozani**. Sipas raportit të shërbimit të punonjësve të policisë të përpiluar nga N/komisar Ylli Çako, datë 22.11.2018, nga ana e tij dhe ndhmës specialistëve të tjerë janë evidentuar dy persona të dhunshëm. Pasi është shoqëruar si person i dyshuar, rezulton se shtetasi Lulezim Dozani ishte pjesëmarrës në protestë, por nuk ka kryer veprime të dhunshme. Pas verifikimit rezultoi se personi i dhunshëm ishte bashkëshortja e tij, shtetësja **Erjona Dozani**.

Cmojme sa me sipër referuar mekanizmit të veprës penale, veprimeve aktive të secilit prej të arrestuarve dhe pasjoave të ardhura

Sa më sipër, bazuar në nenet 228, 229, 230, 234, 238, 251/1 e 252, si dhe nenet 244/1 e 258/1 të Kodit të Procedurës Penale,

#### KËRKOJMË:

1. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë të shtetasit Erald Muçaj, I biri I Isakut dhe Adrianes, I dtl.21.08.1996, lindur ne Tirnae dhe banues ne Tirnae, rruga Aleksander Moisiu, pall 6/2 prane Raifeisen Bank, I padenuar me pare.
2. Caktimin e masës së sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore \_” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
3. Vleftësimin e ligjshem te arrestit ne flagrance te shtetasit Ali Nalic, I biri I Tahirit dhe Drites, I dtl.03.09.1983 , lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane , ish Uzina e Autotraktoree, banese private pa numer.
4. Caktimin e masës së sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore \_” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
5. Vleftësimin sit e ligjshem te shtetasit Alban Ahmetcenaj, I biri I Qemalit dhe Hamdijes, I dtl.30.09.1982, lindur ne Mat dhe banues ne Tirane, rruga Xhevat Gjata, banese private.
6. Caktimin e masës së sigurimit “detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore \_” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.

7. Vlefesimin sit e ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Paolo Ahmetcenaj, I biri I Arjetit dhe Martes, I dtl .03.07.2001, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane rruga Xhavit Gjata, banese private.
8. Caktimin e masës së sigurimit ‘detyrim per tu paraqitur ne policine gjyqesore’ parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
9. Vlefesimin si te ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Lulzim Dozhani, I biri I Arifit dhe Ferides, I dtl.11.04.1973 , lindur ne Bujan Tropoje dhe banues ne Tirane , rruga Gjergj Legisi, blloku I pallateve Gintash.
10. Caktimin e masës së sigurimit “detyrimin per tu paraqitur ne policine gjyqesore ” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale.
11. Vlefesimin e ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Fluturim Goleci, I biri I Rexhepit dhe Sadetes, I dtl.20.05.1988, lindur ne Diber dhe banues ne Tirane Paskuqan 2.
12. Caktimin e masës së sigurimit “ arrest ne burg \_” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
13. Vlefesimin sit e ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Ruzhdi Daci, I biri I Dukagjinit dhe Xhevahires, I dtl.01.06.1965, lindur ne Diber dhe banues ne Unaza e Re, banese private.
14. Caktimin e masës së sigurimit ‘arrest ne burg’ parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
15. Vlefesimin si te ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Marsel Velillari, I biri I Mbarimit dhe Lindites,I dtl.12.03.1990, lindur ne Pogradec dhe banues ne Tirane prane Televizionit Klan.
16. Caktimin e masës së sigurimit “arrest ne burg \_” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
17. Vlefesimin si te ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Dorjan Protoduari, I biri I Florit dhe Lindites, I dtl.03.09.1988, lindur ne Skrapar dhe banues ne Tirane rruga teodor Keko, banese private.
18. Caktimin e masës së sigurimit ‘ arrest ne burg ” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
19. Vlefesimin si te ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Amarildo Sinanaj, I biri I BExhetit dhe Lumturijes, I dtl.04.02.1988, lindur ne Vlore dhe banues ne Tirane, rruga Teodor Keko, banese private nr 27.
20. Caktimin e masës së sigurimit “arrest ne burg \_” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.
21. Vlefesimin sit e ligjshem te arrestit ne flagrante te shtetasit Shpati Bilbilaj, I biri I Hyso dhe Lumturise, I dtl.20.08.1987, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, Unaza e Re, rruga Fejzi Hizmo, banese private.



22. Caktimin e masës së sigurimit “ arrest ne burg \_” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.

PROKURORET

KRESHNIK AJAZI NDINI TAVANI

[Shqiptaria.com]